

**20252584988**

Në bazë të nenit 40-a paragrafi (3) të Ligjit për asimin e mesëm (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 229/20, 78/25, 132/25 dhe 250/25), ministri i Arsimit dhe Shkencës, miratoi

**RREGULLORE PËR PËRBËRJEN DHE MËNYRËN E PUNËS SË TRUPAVE LIDHUR  
ME TË GJITHA LLOJET E PROVIMEVE PËR PËRFUNDIMIN E ARSIMIT TË  
MESËM**

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet përbërja dhe mënyra e punës së trupave lidhur me të gjitha llojet e provimeve për përfundimin e arsimit të mesëm.

Neni 2

Zbatimi e të gjitha llojeve të provimit për përfundimin e arsimit të mesëm, e kryejnë:

- Komisioni i Maturës Shkollore (në tekstin e mëtejme: KMSH);
- Komisioni Shtetëror Lëndor i Maturës (në tekstin e mëtejme: KSHLM);
- Komisioni Shkollor Lëndor (në tekstin e mëtejme: KSHL);
- Komisioni për Detyrën Projektuese (në tekstin e mëtejme: KDP);
- Komisioni për Pragun e Kalushmërisë (në tekstin e mëtejme: KPK);
- Komisioni Lëndor për Ankesa (në tekstin e mëtejme: KLA);
- Komisioni për shqiptimin e masave për shkeljen e rregullave për dhënie të provimeve nga matura shtetërore;
- Komisioni për zgjidhjen e çështjeve organizative dhe problemeve teknike gjatë dhënies së provimeve nga matura shtetërore;
- Komisioni shkollor për provimin përfundimtar;
- Komisioni lëndor i provimit për zhvillimin e provimit me shkrim nga gjuha amtare dhe letërsia në provimin përfundimtar (në tekstin e mëtejme: Komisioni lëndor i provimit për provimin përfundimtar) dhe
- Komisioni i provimit për zhvillimin e punës praktike me mbrojtje në provimin përfundimtar (në tekstin e mëtejme: Komisioni i provimit për punë praktike).

Neni 3

(1) KMSH-ja përbëhet nga: kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe tre anëtarë, si dhe zëvendësit e tyre.

(2) Kryetari i komisionit të maturës shkollore është drejtori i shkollës.

(3) Zëvendëskryetari, sekretari dhe anëtarët e KMSH-së emërohen nga drejtori i shkollës në fillim të vitit shkollor, për periudhën nga 15 shtatori i vitit shkollor aktual deri më 14 shtator të vitit të ardhshëm shkollor.

(4) Përbërja e KMSH-së shpallet në tabelën e shpalljeve të shkollës më së voni deri më 15 shtator të vitit shkollor aktual.

(5) Punët administrativo-organizative të KMSH-së kryhen nga sekretari i KMSH-së.

(6) Në shkollat ku ekzistojnë paralele të arsimit në gjimnaze dhe profesionale në disa gjuhë mësimore, si dhe në shkollat të vendosura në objekte të ndryshme në lokacione të ndryshme, numri i anëtarëve dhe i zëvendësanëtarëve të KMSH-së, sipas nevojës, mund të rritet edhe për tre anëtarë/zëvendës.

#### Neni 4

(1) KSHLM-ja formohet nga drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve (në tekstin e mëtejshëm: QSHP) dhe përbëhet nga kryetari, së paku dy, dhe më së shumti gjashtë anëtarë dhe koordinatori.

(2) Çdo KSHLM ka edhe lexues të pavarur, i cili është nga radhët e kuadrit mësimor-shkencor nga institucionet e arsimit të lartë në shtet, për lëndën përkatëse, përkatësisht fushën përkatëse.

(3) Kryetari është nga radhët e kuadrit mësimor-shkencor të institucioneve të arsimit të lartë në shtet, ndërsa anëtarët e tjerë janë mësimdhënës nga shkollat e mesme, për lëndën mësimore përkatëse.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse nuk mund të sigurohet numër i mjaftueshëm anëtarësh, KSHLM-ja mund të formohet edhe me një anëtar nga radhët e mësimdhënësve të shkollave fillore/ të mesme për lëndën mësimore përkatëse.

(5) Koordinatori i KSHLM-së zgjidhet nga radhët e këshilltarëve në QSHP.

#### Neni 5

(1) KSHL-ja përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë.

(2) Kryetari dhe anëtarët emërohen nga drejtori i shkollës për periudhën nga 15 shtatori i vitit shkollor aktual deri më 14 shtator të vitit të ardhshëm shkollor.

(3) Në KSHL-në së paku një anëtar është mësimdhënës i lëndës përkatëse, ndërsa nëse kjo nuk mund të sigurohet, anëtar i KSHL-së mund të jetë edhe mësimdhënës nga një shkollë tjetër që i plotëson kushtet për mësimdhënës të asaj lënde, ose mësimdhënës i një lënde të afërt nga e njëjta shkollë.

(4) Sipas nevojës, për procesin e vlerësimit për një lëndë në shkollë mund të formohen më shumë komisione lëndore shkollore, në varësi të numrit të nxënësve të paraqitur.

#### Neni 6

(1) KDP përbëhet nga mësimdhënësi–mentor i kandidatit të nxënësit dhe dy mësimdhënës të lëndës përkatëse ose të një lënde/fushe të afërt.

(2) Kryetari dhe anëtarët e KDP-së emërohen nga drejtori i shkollës.

(3) Kryetar i KDP-së nuk mund të jetë mësimdhënësi–mentor i kandidatit

(4) Kryetari kujdeset për zhvillimin e rregullt të provimit dhe mban procesverbal.

#### Neni 7

(1) KPK për një lëndë të caktuar mësimore, si rregull, përbëhet nga tre anëtarë të KSHLM-së dhe tre vlerësues për lëndën përkatëse.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse nuk mund të sigurohet numër i mjaftueshëm anëtarësh nga KSHLM-ja ose vlerësuesish për lëndën përkatëse, KPK-ja për lëndën përkatëse mësimore mund të formohet edhe me numër më të vogël anëtarësh, por jo më pak se dy anëtarë, prej të cilëve njëri është anëtar i KSHLM-së dhe një anëtar vlerësues për lëndën përkatëse.

(3) KPK-ja për lëndën përkatëse mësimore formohet nga drejtori i QShP-së, me propozim të koordinatorit lëndor të provimit ekstern të maturës shtetërore, maturës shtetërore profesionale dhe maturës shtetërore të artit.

#### Neni 8

(1) KLA përbëhet nga tre anëtarë, përkatësisht: një anëtar nga KSHLM-ja, një përfaqësues i QShP-së dhe një përfaqësues nga radhët e vlerësuesve.

(2) Kryetar i komisionit është përfaqësuesi i QShP-së.

(3) KLA-ja formohet nga drejtori i QShP-së.

(4) Sipas nevojës, për një lëndë të caktuar mund të formohen edhe më shumë se një KLA, në varësi të numrit të ankesave të paraqitura nga nxënësit.

#### Neni 9

(1) Komisioni për shqiptimin e masave për shkeljen e rregullave të dhënies së provimeve të maturës shtetërore / maturës shtetërore profesionale / maturës shtetërore të artit formohet nga drejtori i QShP-së dhe përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe tre anëtarë.

(2) Kryetar i komisionit nga paragrafi (1) i këtij neni është drejtori ose zëvendësdrejtori i QShP-së.

(3) Zëvendëskryetari dhe anëtarët janë nga radhët e këshilltarëve ose të punonjësve të QShP-së.

#### Neni 10

(1) Komisioni për zgjidhjen e çështjeve organizative dhe problemeve teknike gjatë dhënies së provimeve të maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/ maturës shtetërore të artit formohet nga drejtori i QShP-së dhe përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë.

(2) Kryetari dhe anëtarët e komisionit janë nga radhët e të punësuarve në QShP, të emëruar nga drejtori i QShP-së.

#### Neni 11

(1) Komisioni shkollor për provimin përfundimtar përbëhet nga: kryetari, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre. Kryetar i Komisionit shkollor është drejtori i shkollës

(2) Zëvendëskryetari, anëtarët dhe zëvendësit e tyre të Komisionit shkollor për provimin përfundimtar emërohen nga drejtori i shkollës, në fillim të vitit shkollor, për periudhën nga 15 shtatori i vitit shkollor aktual deri më 14 shtator të vitit të ardhshëm shkollor.

(3) Përbërja e Komisionit shkollor për provimin përfundimtar shpallet në tabelën e shpalljeve të shkollës, më së voni deri në fund të shtatorit të vitit shkollor aktual.

(4) Punët administrativo-organizative të Komisionit shkollor për provimin përfundimtar kryhen nga sekretari i shkollës.

(5) Në shkollat ku ekzistojnë paralele të vendosura në objekte të ndryshme në lokacione të ndryshme, si dhe në shkollat ku mësimi zhvillohet në disa gjuhë mësimore, numri i anëtarëve të Komisionit shkollor për provimin përfundimtar, sipas nevojës, mund të rritet edhe për dy anëtarë shtesë.

#### Neni 12

(1) Komisioni lëndor i provimit për provimin përfundimtar përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë, prej të cilëve së paku dy anëtarë janë mësimdhënës të gjuhës mësimore përkatëse dhe letërsisë, ndërsa anëtari i tretë është nga fushat nga të cilat janë pranuar temat e fushës profesionale për të cilën arsimohet kandidati.

(2) Kryetari dhe anëtarët emërohen nga drejtori i shkollës, me propozim të Komisionit shkollor për provimin përfundimtar, për periudhën nga 15 shtatori i vitit shkollor aktual deri më 14 shtator të vitit të ardhshëm shkollor.

(3) Sipas nevojës, për një lëndë në shkollë mund të formohen më shumë komisione lëndore të provimit, në varësi të numrit të nxënësve të paraqitur.

#### Neni 13

(1) Komisioni i provimit për punë praktike përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë.

(2) Kryetari dhe një anëtar i Komisionit të provimit emërohen nga drejtori i shkollës, me propozim të Komisionit shkollor për provimin përfundimtar, për periudhën nga 15 shtatori i vitit shkollor aktual deri më 14 shtator të vitit të ardhshëm shkollor, nga radhët e mësimdhënësve të

profesionit. Nëse në shkollë nuk është e mundur të sigurohen dy mësimdhënës nga fusha profesionale përkatëse, anëtar i komisionit mund të jetë edhe mësimdhënës nga një shkollë tjetër që i plotëson kushtet për mësimdhënës të asaj fushe.

(3) Kryetar i komisionit nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mund të jetë mësimdhënësi-mentor i kandidatit të nxënësit. Anëtari i dytë i Komisionit të provimit për punë praktike emërohet nga drejtori i shkollës, me propozim të dhomave, shoqatave të punëdhënësve, nga radhët e Këshillit socio-ekonomik të komunës ose nga radhët e partnerëve socialë me të cilët shkolla ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi.

#### Neni 14

(1) Trupat nga nenet 3, 7, 9, 10 dhe 11 të kësaj rregulloreje, punojnë në mbledhje.

(2) Vendimet e trupave nga paragrafi (1) të këtij neni, miratohen me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

#### Neni 15

(1) Trupi nga neni 8 të kësaj rregulloreje, punon në mbledhje pune.

(2) Vendimet e trupit nga paragrafi (1) të këtij neni, miratohen me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

#### Neni 16

(1) Kryetari, anëtarët dhe lexuesi i pavarur i trupit nga neni 4 të kësaj rregulloreje, i kryejnë detyrat e tyre individuale, pa pjesëmarrjen e anëtarëve të tjerë, për shkak të specifikës së punës dhe detyrave të punës që i kanë.

(2) Koordinator i trupit nga neni 4 të kësaj rregulloreje, e koordinon punën ndërmjet kryetarit, anëtarëve të KSHLM-së dhe lexuesit të pavarur.

#### Neni 17

(1) Kryetari dhe anëtarët e trupave nga nenet 5 dhe 12 të kësaj rregulloreje i kryejnë detyrat e tyre individualisht në pjesën e përgatitjes së detyrave të provimit, ndërsa së bashku e përgatisin testin dhe vendosin në pjesën e vlerësimit të nxënësve.

(2) Vendimet e trupave nga paragrafi (1) të këtij neni, në pjesën e vlerësimit të nxënësit, i miratojnë së bashku nga të gjithë anëtarët e trupit.

#### Neni 18

Trupat nga nenet 6 dhe 13 të kësaj rregulloreje, gjatë përcaktimit të notës së nxënësit, marrin pjesë me 50% mësimdhënësi – mentor, ndërsa dy anëtarët e tjerë me nga 25%, në përputhje me programet përkatëse të provimit.

#### Neni 19

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, ndërsa do të fillojë të zbatohet nga viti shkollor 2026/2027.

Nr. 18-15872/3  
17.12.2025  
Shkup

Ministër  
i Arsimit dhe Shkencës,  
Pr. Dr. **Весна Јаневска**, d.v.